



Komuna e Lipjanit  
Opština Lipjan - Municipality of Lipjan

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E  
KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI I KOMUNËS SË  
LIPJANIT 2024-2026**

Lipjan, shkurt 2024

Komuna e Lipjanit

Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026

Ky dokument u miratua nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 08.05.2024

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	
Përmbledhjeekzekutive .....	
1. Hyrje .....	
2. Metodologjia .....	
3. Analiza e gjendjes .....	
3.1. Arsimi .....	
3.2. Punësim dhe mirëqenia sociale .....	
3.3. Shëndetësia .....	
3.4. Banimi .....	
3.5. Diskriminimi .....	
4. Vizioni, misioni, vlerat dhe parimet .....	
5. Objektivat strategjike .....	
5.1. Arsimi .....	
5.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale .....	
5.3. Shëndetësia .....	
5.4. Banimi .....	
5.5. Diskriminimi .....	
6. Buxheti .....	

## **Lista e shkurtesave**

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
DSHPS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KK	Kuvendi Komunal
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
QM	Qendër Mësimore
QKMF	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra të Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SHFMU	Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët
SHML	Shkolla e Mesme e Lartë
VoRAE	Zëri i Romëve, Ashkalinjve
ZKKK	Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Lipjanit është komuna në të cilën jetojnë rreth 57605 banorë ku prej tyre 3.67% i përkasin komuniteteve rom dhe ashkali. Situata e përgjithshme e këtyre komuniteteve në këtë komunë vlerësohet të jetë e ngjashme me shumicën e komunave tjera ku jetojnë këto dy komunitete dhe konsiderohet se ende ka nevojë për përmirësimin e situatës së tyre në shumë fusha e drejtime, andaj kërkohet një fokus më i madh i Komunës së Lipjanit në këtë drejtim.

Bazuar në strategji dhe plan veprimi përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2022-2026. Komuna e Lipjanit e bëri hartimin e këtij “Plani Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2024-2026”. Ky plan veprimi është hartuar bazuar kryesisht në sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga vet komuna, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale, si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe të grupeve avokuese që merren me çështjet e komuniteteve rom dhe ashkali në këtë komunë, të cilët e kanë themeluar Komiteti Komunal Veprues për hartimin e këtij plani lokal të veprimit.

Komiteti Komunal Veprues për hartimin e “Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2024-2026” ka vendosur që në kuadër të këtij plani lokal të veprimit të përfshihen pesë fushat në vijim:

- Arsimi
- Punësimi dhe mirëqenia sociale
- Shëndetësia
- Banimi
- Diskriminimi

Në pjesën e parë, Komitetin Komunal Veprues ka përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet mbi të cilat ndërtohet ky plan veprimi. Tufje, për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan veprimi është bërë analiza e gëndjes, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjike, janë përcaktuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara, realizimi i të cilave do të ndikojë në përmirësimin e situatës së përgjithshme të këtyre komuniteteve në Komunën e Lipjanit. Po ashtu, janë përcaktuar edhe treguesit për secilin objektivi, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani të veprimit.

Në fund është përcaktuar buxheti për këtë plan veprimi nga ku del se “Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2024-2026” parashihet që për periudhën tre vjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej 200,770.00€ prej të cilave 123,970.00€ parashihen të mbulohen nga buxheti i Komunës së Lipjanit, ndërsa 76,800.00€ parashihen të mbulohen nga donatorët e ndryshëm dhe/ose institucionet qëndrore të Kosovës.

## 1. Hyrje

Komuna e Lipjanit gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në këtë komunë jetojnë rreth 2500 (Dymijë e pesëqind), pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali. Vlerësohet se në Komunën e Lipjanit në përgjithësi gjendja e komuniteteve rom dhe ashkali është e mirë krahasuar me komunat tjera të Kosovës ku jetojnë komunitete, por sërish konsiderohet se gjendja e tyre duhet përmirësuar në shumë aspekte.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Lipjanit është 57.605 banorë<sup>1</sup>. Pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë 94.8%, ndërsa 0.88% janë serbë, 0.41% rom, 3.67% ashkali, dhe 0.03% të tjerë. Moshja e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40 % janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 -65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç. Mesatarja e madhësisë së familjeve është pesë anëtarë. Komuna e Lipjanit ka gjithsej 2154 mijë banorë të komuniteteve rom (342), ashkali (1812) (4). Pjesëtarët e këtyre komuniteteve jetojnë kryesisht në fshatrat Medvec, Magure, Rufe, Gadime, Janjevë dhe në Lipjan.

## 2. Metodologjia

I gjithë procesi i hartimit të “Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2024-2026, ka pasur në dispozicion një perudhë kohore të konsiderueshme dhe ka qenë proces gjithpërfshirës. Ky plan veprimi është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga Kryetari i Komunës, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale, si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe të grupeve avokuese që merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali në këtë komunë..

Për realizimin e këtij plani lokal të veprimit, Kryetari i Komunës së Lipjanit kanë marrë vendim për themelimin e Komitetit Komunal Veprues me datë 16.02.2023, për hartimin e “Planit Lokal të Veprimit, ku përfshihen Komiteti Rom dhe Ashkali 2024-2026, në Komunën e Lipjanit”, me këtë përbërje:

1. Diamant Bytyqi – *Nënkryetar i Komunitetit – Kryesues*
2. Rasim Hasani – *Drejtor i Drejtoratit për Arsimit, anëtar*
3. Shkëlzen Hajdini – *Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar*
4. Albert Mustafa – *Shef i Sektorit DSHPS dhe zyrtar përgjegjës nga fusha e banimit, anëtar*
5. Lidija Jovanovic – *Zyra Lokale për Komunitete*
6. Fjolla Ibrahim – *QPS dhe zyrtare për mbrojtjen e fëmijës*
7. Hasan Luma – *Zyrtar për barazi gjinore*
8. Shahadije Ibrahim – *Shefe e Sektorit për Buxhet dhe Financa*
9. Sunaj Garip – *OJQ- “All Youth Together, anëtar*
10. Adelina Qorraj Emiri – *OJQ- Women “Alliance for integration”, anëtare*
11. Majlinda Krasniqi – *OJQ “The ideas Partnership”, anëtar*
12. Shkelqim Bahtiri – *OJQ “Ipkofoundation”, anëtar*

*Ndërsa në bazë të vendimit të kryetarit të komunës, koordinator i këtij komiteti është caktuar Behar Aliu, zyrtar ligjor, në sektorin për punë të Kuvendit*

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2024-2026, deri te miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi i Komunës i Lipjanit ka kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Fazat në fjalë janë të përshkruara shkurtimisht në vijim:

**Faza I:** Përgatitja gjatë kësaj faze përfaqësuesit e Komitetit Komunal Veprues, caktuandisa takime, ku diskutojnë për hartimin e planit të veprimit, dhe të gjithë anëtarët kanë marr obligim që ta përgadisin analizen e gjendjes dhe mbledhjen e të dhënave.

**Faza II:** Përcaktimi i fushave Komiteti Komunal Veprues ka diskutuar dhe është përcaktuar për fushat që do të përfshihen në këtë plan të veprimit.

**Faza III:** Përcaktimi i objektivave dhe aktiviteteve

Për nevoja të planifikimit, më 22 qershor 2023 është mbajtur një takim me Komitetin Komunal Veprues nën moderimin e konsulentëve dhe me pjesëmarrjen anëtarëve të Komitetit. Gjatë këtij takimi, për secilën fushë që është përfshirë në këtë plan veprimi, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjikë, janë definuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara. Gjithashtu, gjatë këtij takimi janë definuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani të veprimit.

**Faza IV:** Planifikimi i buxhetit dhe planit të zbatimit

Për nevoja të planifikimit të buxhetit dhe të planit të zbatimit të këtij plani lokal të veprimit, më 22 qershor 2023 është mbajtur një takim me antëtarët e Komitetit Komunal Veprues. Në këtë takim, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues, është përcaktuar buxheti për të gjitha aktivitetet e parapara për periudhën trevjeçare, duke e ndarë në kategori varësisht prej burimit të financimit, si dhe është detajuar plani i zbatimit të këtij plani lokal të veprimit për periudhën trevjeçare, duke i operacionalizuar aktivitetet e parapara dhe duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

**Faza V:** Hartimi dhe dorëzimi i draftit të parë të planit të veprimit

Në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit, në përfundim të tij u hartua edhe drafti i Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali, në Komunën e Lipjanit 2024-2026, i cili pasi u shqyrtua nga Komiteti Komunal Veprues, mori formën e draftit përfundimtar.

### 3. Analiza e gjendjes

Pas konsultimeve dhe diskutimeve që ka zhvilluar Komiteti Komunal Veprues për hartimin e planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali 2024-2026 në Komunën e Lipjanit, ka vendosur që në kuadër të këtij plani të veprimit të përfshihen pesë fusha kryesore, të cilat janë edhe pjesë e strategjisë shtetërore në nivel të Kosovës “Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2022–2026”.

Komiteti Komunal Veprueska vendosur që në kuadër të planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali, 2024-2026 në Komunën e Lipjanit të përfshihen pesë fushat në vijim:

- Arsimi
- Punësimi dhe mirëqenia sociale
- Shëndetësia
- Banimi
- Diskriminimi

Punësitoria e parë për analizën e gjendjes për këto pesë fusha është organizuar më 02 maj 2023 nga OSBE, dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësues: Zyra për qeverisje të mirë, anëtarët e Komitetit Komunal Veprues të Komunitetit Rom në Lipjanit, dhe organizata jo-qeveritare që punojnë me komunitetet rom dhe ashkali në këtë komunë. Kjo punëtori është moderuar nga konsulentët dhe gjatë saj është bërë një analizë e gjendjes ekzistuese e komuniteteve rom dhe ashkalinë Komunën e Lipjanit për këto pesë fusha.

Për analizën e gjendjes në këto pesë fusha është përdorur analiza e anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues, në mënyrë që të identifikohen sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Zyratë komunalë dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që kanë marrë pjesë në këtë qeshitje, po ashtu kanë kontribuar në identifikimin e suksesëve dhe mundësive, si dhe të dobësive dhe rreziqeve për këto pesë fusha dhe kanë ofruar një bazë të kënaqshme për të analizuar shkaqet e pasojat e gjendjes jo të kënaqshme të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Lipjanit. Andaj, krahas dobësive dhe suksesëve që varen kryesisht nga niveli lokal, janë analizuar edhe faktorët e jashtëm që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në të ardhmen, si dhe në mënyrë objektive janë trajtuar dhe analizuar mundësitë dhe rreziqet. E gjithë analiza është bërë në grupe të vogla të punës, puna e të cilëve pastaj është shpalosur para grupit të gjerë dhe të gjitha çështjet janë diskutuar një nga një.

Përveç të dhënave që kanë dalë nga analiza e anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues, konsulentët kanë përgatitur edhe një formular të posaçëm për zyratë e Komunitetit Rom në Lipjanit, përmes të cilit janë kërkuar të dhëna dhe statistika zyrtare të nevojshme për analizën e gjendjes. Gjithashtu, konsulentët kanë siguruar edhe të dhëna dhe statistika të tjera zyrtare nga OJQ-të, nga institucionet qendrore dhe nga dokumentet e ndryshme zyrtare publike, në mënyrë që të bëhet një analizë dhe prezantim sa më real dhe objektiv, i mbështetur në të dhëna.

Para se të bëhet një prezantim i gjendjes për pesë fushat e sipër-përmendura, fillimisht do të bëhet një prezantim i përgjithshëm për Komunën e Lipjanit dhe për komunitetet rom dhe ashkali që jetojnë në këtë komunë.

Në vijim është prezantuar një përmbledhje e analizës së gjendjes sipas fushave.

### 3.1. Arsimi

Në Komunën e Lipjanit përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar është në nivel jo të kënaqshëm. Sipas statistikave zyrtare të DKA-së së Lipjanit, asnjë fëmijë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali të moshës 0-5 vjeçare nuk vijon edukimin parashkollor në Komunën e Lipjanit. Në nivelin e arsimit të detyruar, përkatësisht në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1 – 9), në Komunën e Lipjanit janë të përfshirë gjithsej 501 nxënës (250 meshkuj dhe 251 femra) të këtyre komuniteteve, përkatësisht 445 nxënës (216 meshkuj dhe 229 femra) të komunitetit ashkali dhe 53 nxënës (17 meshkuj dhe 16 femra) të komunitetit rom, të cilët vijojnë shkollimin kryesisht në vendbanimet Medvec, Magure, Rufe, Lipjan, Gadime dhe Janjevë<sup>2</sup>. Shkollimin e mesëm të lartë (klasat 10 – 12) vijojnë gjithsej 19 nxënës (13 meshkuj dhe 6 femra) të komunitetit, ashkali. Komuna e Lipjanit nuk ka të dhëna zyrtare se sa është numri i fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali të kësaj komune që nuk janë të përfshirë në secilin nga nivelet e sipër-përmendura të edukimit/arsimit para universitar, prandaj dhe është e pamundur që të konstatohet me saktësi për nivelin e përfshirjes. Pavarësisht kësaj, duke e pasur parasysh që në Komunën e Lipjanit jetojnë gjithsej 2158 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe bazuar në numrin e nxënësve të këtyre komuniteteve që vijojnë arsimin e detyruar (501), mund të konstatohet se niveli i përfshirjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në arsimin e detyruar është mjaft i lartë, ndërsa përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në arsimin e detyruar është mjaft e ulët, ndërsa përfshirja e Lipjanit është shumë e ulët.

---

<sup>2</sup> Të gjitha statistikave të arsimit të përfshira këtu janë statistika të DKA-së për vitin shkollor 2022-2023



Pavarësisht se nuk ka të dhëna zyrtare, vlerësohet se fenomeni i braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit është prezen por mbetet që në të ardhmen të ketë një angazhim më të madh në funksion të zvogëlimit ose eliminimit të fenomenit të braktisjes.

Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me donatorët e ndryshëm, me QM-të dhe OJQ-të e ndryshme që merren me adresimin e problemeve të komuniteteve rom, ashkali ka qenë aktive dhe ka ndihmuar në organizimin e fushatave vetëdijesuese tek komunitetet rom, ashkali për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve. Komuna e Lipjanit ka qenë e angazhuar edhe në ofrimin e mësimin shtesë nëpër QM për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali, gjë e cila mund të ndikojë në rritjen e suksesit të këtyre nxënësve gjatë shkollimit.

Mbetet që Komuna e Lipjanit të angazhohet edhe në të ardhmen për rritjen e përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar në këtë komunë, me theks të veçantë përfshirjen e fëmijëve/nxënësve në sistemin parashkollor, punësimin e edukatorëve dhe mësimdhënësve nga radhët e komuniteteve rritjen e bashkëpunimit me prindërit, adresimin dhe parandalimin e braktisjes së shkollimit nga nxënësit e këtyre komuniteteve, përkrahjen me materiale shkollore për nxënësit e familjeve me gjendje të rëndë ekonomike, përkrahjen me bursa për nxënësit e shkollimit të mesëm të lartë, organizimin e fushatave vetëdijesuese dhe informuese, etj..

Komuna e Lipjanit parasheh që në funksion të përmirësimit të situatës së përgjithshme të arsimit për komunitetet rom, ashkali në këtë komunë të shfrytëzojë edhe mundësitë tjera që dalin përtej nivelit lokal, siç janë: gatishmëria e donatorëve të ndryshëm për të përkrahur në forma të ndryshme arsimimin e këtyre komuniteteve, përkrahja me pako shkollore dhe me bursa nga institucionet qendrore dhe donatorët e projektet e ndryshme (për momentin 32 nxënës të shkollave të mesme të larta të këtyre komuniteteve marrin bursa nga MASHT dhe donatorët tjerë), burimet dhe format e përkrahjes nga institucionet qendrore që parashihen me dokumentet strategjike “Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2022 – 2026” dhe “Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021”.

Komuna e Lipjanit gjithashtu është e vetëdijshme se gjendjes së përgjithshme jo të mirë në fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali në këtë komunë i kontribuojnë edhe shkaktarët tjerë që nuk varen ekskluzivisht nga Komuna e Lipjanit, siç janë: niveli i lartë i papunësisë në mesin e këtyre komuniteteve, gjendja e rëndë ekonomike në shumë nga këto familje, numri shumë i vogël i kuadrove nga mesi i këtyre komuniteteve me arsim universitar, fenomeni i martesave të hershme në mesin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, mungesa e buxhetit të nevojshëm në nivel lokal e qendror, etj.

### **3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale**

Niveli i lartë i papunësisë në Kosovë në përgjithësi, është shumë më i theksuar në mesin e komuniteteve rom, ashkali. Kjo gjendje reflektohet edhe në nivel komunal në Komunën e Lipjanit. Pra, niveli i papunësisë në mesin e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit llogaritet të jetë jashtëzakonisht shumë i lartë krahasuar me nivelin e papunësisë në nivel të përgjithshëm të popullatës në këtë komunë.

Nga gjithësej 2154 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali që jetojnë në Komunën e Lipjanit, vetëm 5 janë të punësuar në sektorin publik në nivel komunal, 8 janë të punësuar në sektorin publik në nivel qendror, dhe rreth 30 persona në vitë punësohen si të punësuar sezonalë.

Përveç shkaktarëve të përgjithshëm që ndikojnë në nivelin e lartë të papunësisë, ka edhe shkaktarë të veçantë që i kontribuojnë papunësisë së madhe të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit. Njëri nga këta shkaktar është mungesa e kuadrove me kualifikime universitare nga radhët e këtyre komuniteteve, gjë që pamundëson ose vështirëson punësimin e tyre në mungesë të plotësisht të kriterëve ligjore, posaçërisht në sektorin publik, sidomos deri në arrijten e plotësisht të kuotave për punësimin e komuniteteve që parashihen me ligj.

Vien të theksohet se Komuna e Lipjanit në shumë raste, sidomos për punësime sezonale ka arritur që të punësojë 11 persona të komuniteteve rom, ashkallite kompania publike "Pastrimi", si dhe i ka angazhuar 8 punëtorë sezonalë nga këto komunitete për rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Gadimë<sup>3</sup>. Komuna e Lipjanit gjithashtu ka bashkëpunuar me sektorin privat për krijimin e vendeve të punës për pjesëtarët e këtyre komuniteteve dhe si rezultat i kësaj ka punësuar nga disa persona radhët e komuniteteve rom, ashkali me metodë të pagesës 51% me 49% të pagës për një periudhë tre deri gjashtë muaj. Sidoqoftë kjo metodë ka kohëzgjatje të shkurtër 3 deri në 6 muaj dhe rreziku është mjaft i lartë që pas këtij subvencioni bizneset mund t'i largojnë të punësuarit prapë nga vendet e punës pas përfundimit të marrëveshjes me komunën.

Pavarësisht se Komuna e Lipjanit ka qenë mjaft e angazhuar për adresimin e problemit të papunësisë në mesin e komuniteteve rom, ashkali, sërish vlerësohet se Komuna e Lipjanit duhet të jetë edhe më e angazhuar në drejtim të rritjes së punësueshmërisë në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe në këtë komunë, duke arritur kuotat ligjore për punësimin e komuniteteve (së paku për ata që i plotësojnë kriteret ligjore), duke i stimuluar në forma të ndryshme nxënësit dhe studentët e këtyre komuniteteve për vijimin dhe përfundimin me sukses të studimeve në universitet, duke ofruar më shumë mundësi për aftësime profesionale (arsim joformal për të rritur) për zanate të ndryshme për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, duke ofruar më shumë subvencione për fushat e caktuara me të cilat merren kryesisht këto komunitete dhe kështu do të rritet vetë-punësimi te pjesëtarët e këtyre komuniteteve, etj.

Komuna e Lipjanit mbetet që të shqyrtojë edhe mundësitë dhe burimet tjera, jashtë kapaciteteve të saj, për të adresuar nivelin e lartë të papunësisë së komuniteteve rom, ashkali në këtë komunë. Në kuadër të kësaj, Komuna e Lipjanit mund të bashkëpunojë më shumë me Qendrën për Punë Sociale dhe QAP, në mënyrë që pjesëtarët e këtyre komuniteteve të kryejnë sa më shumë trajnime profesionale dhe të ju jepet përparësi punësimi në rastet e kushteve të barabarta me të tjerët. Gjithashtu, Komuna e Lipjanit duhet të hulumtojë edhe për mundësinë e bashkëpunimit me donatorët e ndryshëm, me institucionet qendrore dhe me sektorin privat, në funksion të punësimit të komuniteteve rom, ashkali në këtë komunë.

Me një nivel kaq të lartë të papunësisë në mesin e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit, sigurisht që është e pritshme që shumica e familjeve të këtyre komuniteteve jetojnë gjendje të rëndë të mirëqenies sociale në këtë komunë. Këtë konstatim e mbështetë edhe fakti që janë gjithsej 210<sup>4</sup> familje të komuniteteve rom, ashkali në këtë komunë që marrin asistencë sociale.

### 3.3. Shëndetësia

Në komunën e Lipjanit funksionon një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), katër Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe shtatë punkte shëndetësore apo ambulanca. QKMF gjendet në qendër të qytetit të Lipjanit, ndërsa QMF-të janë të shpërndara nëpër vendbanime të ndryshme,

<sup>3</sup> Të dhëna sipas deklarimeve të zyrtarëve komunal të Komunitës së Lipjanit.

<sup>4</sup> Ky numër është marrë nga Zyra për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunitës së Lipjanit.

një në fshatin Gadime, një në fshatin Magure, një në fshatin Shalë dhe një në fshatin Janjevë. Punktet shëndetësore gjenden në fshatra tjera të kësaj komune, në Slovi, Rubovc, Kraishtë, Dobrajë, Smallushë, Banullë dhe në Babush .

Janë disa suksese të Komunës së Lipjanit që mund të përmenden kur flasim për fushën e shëndetësisë që lidhet me komunitet rom, ashkali të kësaj komune. Vet prezenca e shërbimeve shëndetësore afër të gjitha vendbanimeve është shumë me rëndësi për këto komunitete, në mënyrë që ta kenë më të lehtë dhe pa kosto të udhëtimit qasjen në këto shërbime. Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për komunitet, Komuna e Lipjanit ka renovuar AMF-të në lokalitetet e populluara me numër të madh të komuniteteve si: ne Gadime, Janjevë dhe Magure. Poashtu, në Qytetin e Lipjanit, ku jetojnë një numër i madh i komunitetit Rom dhe Ashkali ka filluar ndërtimi i Qendrës së Re Urgjente e cila ka për qëllim të avancoj me tutje shërbimet akute dhe urgjente shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit. Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me donatorët dhe me OJQ-të e ndryshme, përveç fushatave vetëdijesuese për rëndësinë e shëndetit të këto komunitete, ka organizuar edhe vizita në shkolla, në QM dhe në familje për të realizuar vaksinimin e fëmijëve të pavaksinuar të këtyre komuniteteve. Vlerësohet se, edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta, 75% e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali të kësaj komune janë të vaksinuar me rregull, dhe mbetet që edhe pjesa tjetër të vaksinohet në vitet në vijim. Komuna e Lipjanit tashmë e ka hequr pagesën e participimit prej 5€ për shërbimet emergjente që është aplikuar më herët dhe reflekton shumë pozitivisht për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe kjo pagesë prej 5€ ka paraqitur pengesë për të marrë shërbimet e nevojshme emergjente shëndetësore. Gjithashtu, Komuna e Lipjanit përmes subvencioneve, ka përkrahur për nevoja shëndetësore rreth 23 familje të komuniteteve rom, ashkali të kësaj Komune, të cilët vuajnë nga sëmundje të ndryshme kronike dhe të cilët jetojnë në kushte të rënda ekonomike.

Fushatat e vetëdijesimit në Komunën e Lipjanit konsiderohen të rëndësishme, veçanërisht me nënat për planifikimin familjar, për higjienën personale, për kujdesin ndaj fëmijëve të porsalindur, etj. Por, koordinimi dhe bashkëpunimi i mëtutjeshëm në mes të QKMF-së dhe OJQ-ve duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen për ofrimin e kësillave për banorët e këtyre komuniteteve për çështje të shëndetësisë dhe për adresat e duhura ku të drejtohen për probleme të ndryshme shëndetësore. Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim edhe me institucionet qendrore, me donatorët dhe OJQ-të e ndryshme, duhet të angazhohet edhe më shumë në organizimin e fushatave vetëdijesuese në radhët e komuniteteve rom, ashkali në këtë komunë për rëndësinë e shëndetit personal dhe publik, organizimin e vizitave nëpër shtëpitë e këtyre komuniteteve deri sa të arrihet vaksinimi i plotë i të gjithë fëmijëve të tyre, ofrim të edukimit shëndetësor për këto komunitete, etj.

Është me rëndësi të përmendet që gjendjes jo të mirë në aspektin e shëndetësisë të komuniteteve rom, ashkali i kontribon shumë gjendja e rëndë socio-ekonomike dhe kushtet e vështira të jetesës së familjeve të këtyre komuniteteve, sidomos në rastet kur kjo gjendje kushtëzon kushte të këqija higjienike, ushqyeshmëri jo të duhur dhe jociësore, pamundësi për kontrolle dhe analiza mjekësore, pamundësi për blerje të barnave të domosdoshme të përshkuara nga mjeku, jetojnë afër deponive të mbeturinave, etj.

### 3.4. Banimi

Komuna e Lipjanit ka 62 vendbanime, ku numër më i madh i tyre janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës që paraqet pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit, ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjik, pjesëve kodrinoro-malore të Komunës së Lipjanit .

Sikur edhe në fushat tjera të sipër-përshkruara, edhe sa i përket banimit, del se komunitet rom, ashkali, të Komunës së Lipjanit kanë mjaft probleme dhe vështirësi, sepse shumë familje kanë probleme me kushte të vështira banimi, me mungesë të pronave private për ndërtim, me probleme të pronësisë, me banime në vendbanime joformale, me vendbanime pa mirëmbajtje të duhur, si dhe me mungesë strehimi.

Komuna e Lipjanit ka qenë mjaft e përkushtuar në zgjidhjen e problemit të banimit dhe strehimit për komunitet rom, ashkali të kësaj komune. Komuna e Lipjanit ka ndërtuar banesa kolektive me karakter social në fshatin Magure, ku ka sistemuar 18 familje të këtyre komuniteteve me gjendje të rëndë ekonomike dhe gjithashtu ka ndërtuar 4 shtëpi në fshatin Medvec për familjet e këtyre komuniteteve. Përveç këtyre, Komuna e Lipjanit ka ndarë edhe 30 ari tokë publike komunale në fshatin Medvec për ndërtimin e shtëpive për familjet e këtyre komuniteteve. Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2018-2023 ka përkrah 28 familje për renovim të shtëpive në bashkepunime me organizatën “VoRAE” (sipas shënimeve nga ZLK), dhe kanë përfunduar 12 familje, me ndërtimin e shtëpive nga themeli, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mireqenies Sociale, si dhe akomodimin e familjeve të këtyre komuniteteve që janë riatdhesuar ka ofruar banim për 1 vit, me mundësi vazhdimi edhe për 6 muja të tjerë nga MPB, ku gjatë kësaj periudhe 2018-2023, ka paguar strehim për familjet e riatdhesuara për 2 familje ashkali dhe 5 familje rom.

Në Komunën e Lipjanit ekzistojnë 6 vendbanime joformale dhe është në rritje numri i të pastrehëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali . Në lidhje me këtë Komuna e Lipjanit këtë vit ka hartuar një program trevjeçar që adreson të gjitha problemet e banimit si dhe i ka dhënë theks të veçantë rregullimit të problemit me vendbanimet kolektive siç është përmirësimi i kushteve të jetesës, mundësinë e legalizimit të vendbanimeve joformale dhe gjetjes së mënyrave për të ofruar zgjidhje për të pastrehët, siç është rasti i adaptimit të disa objekteve të braktisura duke i shndërruar ato në vendbanime kolektive ose shtëpi për individë të pastrehë.

Sa i përket fushës së banimit, Grupi Punues për hartimin e këtij Plani ka qenë i kujdesshëm që aktivitetet e parapara në këtë Plan Veprimi të jenë në linjë me Programin Trevjeçar të Banimit të Komunës së Lipjanit, duke iu referuar aktiviteteve të atij plani, me qëllim të shmangies së kundërthënieve dhe duplikimit të aktiviteteve ndërmjet dy planeve.

### 3.5 Diskriminimi

Diskriminimi është prezent në gjithë popullatën, sidomos në aspektin gjinorë,po edhe numri i romëve dhe ashkallive, që në situatë shoqërore ndihentë diskriminuar përshkak të përkatësisë së tyre etnike është më shumë prezent, sesa tek pjesa tjetër e popullsisë,prandaj ky fenomen kërkon trajtim më afatgjatë. Korniza e BE-së për Integrimin e romëve dhe ashkallive,në të cilën bazohet edhe kjo Strategji, përkufizon luftimin e diskriminimit si: luftimin ediskriminimit, ngacmimit, krimin të urrejtes dhe gjuhës së urrejtes kundër romëve dhe ashkallive promovimin(ndërgjegjësimin) e historisë,kulturës,njohjes dhe pajtimin të romëve dhe ashkallive.

Diskriminimi,është një fenomen që është prezent në fushën e arsimit,punësimin dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, dhe banimit, ku do të trajtohet në këto katër fushat, duke vendosuro bjektiva specifike të veçanta që idedikohen diskriminimit.

Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është defnuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbërthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planine Veprimin janë zbërthyer në rezultate dhe në aktivitete.

#### Përshkrimi i aktiviteve për luftimin e Diskriminimit

Aktiviteti 5.1	Luftimi i të gjitha llojeve të Diskriminimit
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti5.0	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Zhvillimi i materialeve të informimit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali.</li><li>2. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit nëpërmjet mediave të ndryshme, përfshirë media sociale, lajme, dhe programe televizive.</li><li>3. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për të mitur ndërgjegjësimin dhe dritën e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali për profesionistët, punonjësit socialë, edukatorët dhe të tjerë aktorët e rëndësishëm të shoqërisë.</li></ol> Raportimi ne platformat qe luftojne diskriminimin.
Aktiviteti5.1	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Përmirësimi i mekanizmeve të monitorimit dhe raportimit të rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali.</li><li>2. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të diskriminimit.</li><li>3. Zbatim i politikave dhe ligjeve të reja që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali.</li></ol>

Rezultati 5.2:	Ekziston Fondi Emergjent Komunal për nevojat e zgjidhjes së rasteve të banimit/bashkëfinancim të projekteve nga donatorët
Aktiviteti	Përkrahimi i aktivitetit
Aktiviteti 5.2	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi i programeve të trajnimit dhe aftësimit për të rritur mundësitë e punësimit dhe vetëpunësimit për pjestarët e komuniteteve Rom, Ashkali.</li> <li>2. Promovimi i bashkëpunimit midis komuniteteve dhe institucioneve lokale për zhvillimin e projekteve të përbashkëta ekonomike.</li> <li>3. Sigurimi i aksesit të barabartë për shërbime sociale, arsim dhe shëndetësi për komunitetet Rom, Ashkali.</li> </ol>
Aktiviteti 5.3	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në zonat ku jetojnë komunitetet Rom, Ashkali</li> <li>2. Zhvillimi i materialeve të edukimit dhe trajnimit që i përshtaten nevojave specifike të komuniteteve Rom, Ashkali.</li> <li>3. Do të bashkëpunojmë me të gjitha organizatat joqeveritare që merren me regjistrimin e gjendjes civile, të kuminetev rom dhe ashkali.</li> </ol>

## Fusha: Anti-DISKRIMINIMIT

Sigurimi i strehimit dhe banimit formal për familjet e komuniteteve rom, ashkali.

Rezultati 4.1		Avancim indjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali									
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimet e financimit	2023	2024	2025	Totali
5.1.1	Informim dhe ndërgjegjësim i komuniteteve dhe publikut	Zhvillimi i materialeve të informimit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit nëpërmjet mediave të ndryshme, përfshirë media sociale, lajme, dhe programe televizive. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për të rritur ndërgjegjësimin dhe dijen e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali për profesionistët, punonjësit socialë, edukatorët dhe të tjerë aktorët e rëndësishëm të shoqërisë.	2024-2026	ZKKK	Komuna dhe OJQ	2500	Buxheti i komunes	500	1000	1000	2500
5.1.2	Forcimi i ligjshmërisë dhe zbatimit të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali.	Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të diskriminimit. Zbatim i politikave dhe ligjeve të reja që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali.	2024-2026	Komuna	OSHÇ-të, donatorët	2500	ZKKK, donatorët	500	1000	1000	2500
							Totali	1000	2000	2000	5000

#### **4. Vizioni, misioni, vlerat dhe parimet**

Vizioni i Komunës së Lipjanit është që të sigurojn të drejtat dhe mirëqenien e të gjitha komuniteteve dhe të përmbushë standardet më të larta të respektimit të drejtave të njeriut në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me konventat ndërkombëtare.

Për të arritur këtë vizion, Komuna e Lipjanit merr obligim për të gjithë qytetarët të sigurojë të drejta të barabarta, të përmbushë standarde më të lartë për respektimin e të drejtave për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Që të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në arsim, punësim shërbime shëndetësore si dhe kushte më të mira të banimit.

Komuna e Lipjanit planin e vet për përfshirjen e romëve, ashkalinjve e bazon në tri parime kryesore, të harmonizuara me Kornizën evropiane për strategjitë nacionale për Integrimin e romëve dhe ashkalinjve:

- Parimi i të drejtave të barabarta dhe mundësive të barabarta. Komuna e Lipjanit do të jetë e përkushtuar që këtë parim ta respektoj për anëtarët e komuniteteve rom, ashkali që jetojnë në këtë komunë në të gjitha fushat e shoqërisë.
- Parimi i mos diskriminimit –Komuna e Lipjanit do të ndërmarrë të gjitha masat që sigurojnë zvogëlimin e shkallës së diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në këtë komunë.
- Parimi i eliminimit të dallimeve –Komuna e Lipjanit do të jetë e përkushtuar në eliminim e dallimeve ndërmjet komuniteteve rom, ashkali duke ndërmarrë masa për të siguruar që këto dallime të eliminohen.

## 5. Objektivat strategjikë

### 5.1. Arsimi

Arsimi është faktori më i rëndësishëm dhe më i qëndrueshëm për parandalimin e varfërisë dhe për integrimin e komuniteteve rom, ashkali në shoqëri. Vështirësitë kryesore nga radhët e komuniteteve për qasje në punësim dhe në të gjitha aspektet tjera të jetës janë shkaku që e fillojnë vonë arsimimin e tyre, ose që e braktisin herët arsimin dhe mbesin të paarsimuar. Në vijim janë paraqitur sfidat kryesore të identifikuara në Komunën e Lipjanit:

#### **Mos ndërgjegjësimi i mjaftueshëm i prindërve të komuniteteve rom, ashkali për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve në Komunën e Lipjanit.**

Prindërit në Komunën e Lipjanit edhe pse bëjnë përpjekje për të vijuar shkollën fëmijët e tyre ata janë shpesh të demotivuar ose kanë mungesë të informacioneve themelore për regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Prindërit gati fare nuk i vizitojnë fëmijët në shkollë ose të mbajnë takime me stafin e shkollës rreth përparimit të fëmijëve të tyre. Edhe këtu është vlerësuar se niveli i ulët arsimor i familjes dhe shkaqet ekonomike duke përfshirë edhe papunësinë e lartë janë si faktorë kryesor pse prindërit shfaqin shumë pak interesim për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre.

#### **Niveli i ulët i pjesëmarrjes dhe braktisja e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali në arsimin parauniversitar posaçërisht në nivelin e mesëm të ulët dhe nivelin e mesëm të lartë.**

Kjo vërehet me pjesëmarrjen më të ulët në krahasim me komunitetet tjera që jetojnë në Komunën e Lipjanit. Edhe pse Komuna nuk ka ofruar të dhëna sa nuk vijojnë mësimin sipas vlerësimit të tyre është e përafërt me mesataren shtetërore 85%<sup>5</sup> për arsimin fillor dhe gjithashtu kjo shkon duke u zvogëluar në arsimin e mesëm të ulët ku gjithashtu vlerësohet se është e përafërt me mesataren shtetërore me vetëm 65%<sup>6</sup> të fëmijëve rom, ashkali të grup-moshës 11-14, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë zvogëlohet në 30.3%<sup>7</sup>.

#### **Vijueshmëria jo e rregullt dhe sukcesi jo i mirë i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në arsimin parauniversitar në Komunën e Lipjanit krahasuar me suksesin e nxënësve të komunitetit shumicë.**

Në krahasim me komunitetet tjera që vijojnë shkollimin në Komunën e Lipjanit nxënësit e komuniteteve rom, ashkali kanë shumë më shumë mungesa dhe ka një dallim të dukshëm me komunitetet tjera. Ky fenomen më i dukshëm tek ata më të rritur në shkollimin mesëm të ulët dhe sidomos atë të mesëm të lartë dhe kjo lidhet me arsye familjare, shkaqe ekonomike sociale, shëndetësore, transporti nga zonat rurale, etj. Shkak tjetër është cilësia e rezultateve të të nxënësve, që për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali është më e ulët sesa e komunitetit shumicë. Edhe pse komuna nuk ka rezultate të sakta vlerëson se në të gjitha shkollat ku vijojnë këto dy komunitete ekziston një dallim i rezultatit të të nxënësve. Kjo për arsye se së pari asnjë fëmijë në Komunën e Lipjanit nuk është i përfshirë në edukimin parashkollor gjithashtu edhe niveli arsimor i familjeve nuk krijon një mjedis të përshtatshëm për të nxënë në shtëpi. E cila shpesh është shkaktarë për braktisje.

<sup>5</sup>Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2013-2014 – Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (MICS), Raporti final, ASK, Prishtinë 2014, f. VII. <https://ask.rks.gov.net/images/files/Komunitetet%20Rome.%20Ashkali%20dhe%20Egjiptiane%20ne%20Kosove.pdf>

<sup>6</sup>Po aty.

<sup>7</sup>Po aty.

## Objektivi strategjik

Bazuar në sfidat e identifikuar më lartë në Komunën e Lipjanit është e vendosur objektivi strategjik në vijim:

- **Objektivi 1: Rritja e përfshirjes dhe përmirësimi i suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në arsimin parauniversitar në Komunën e Lipjanit.**

Për tu arritur ky objektivi Komuna e Lipjanit parashihet të arrijë rezultatet në vijim:

### Rezultatet e pritshme

- Rezultati 1.1: Prindërit ndërgjegjësohen për rolin dhe rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre, rritin bashkëpunimin me shkollën dhe regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë.
- Rezultati 1.2: Rritja e pjesëmarrjes dhe zvogëlimi i rasteve të braktisjes nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.
- Rezultati 1.3: Përmirësimi i suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.

Për të arritur rezultatet e përmendura më lartë parashihen të ndërmerren aktivitetet në vijim:

### Aktivitetet

Rezultati 1.1: Prindërit ndërgjegjësohen për rolin dhe rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre, rritin bashkëpunimin me shkollën dhe regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë.

Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
<b>Aktiviteti 1.1.1:</b> Organizimi i fushatave informuese për ndërgjegjësimin e prindërve për rëndësinë e shkollës dhe regjistrimin e tyre në shkollë.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 1.1.1:</b> DKA në një theks të veçantë aktivitetet me prindër të cilën do ta realizojë në bashkëpunim me OJQ-të dhe grupet avokuese që veprojnë në Komunën e Lipjanit. Këto aktivitete do të ndërmerren në baza të rregullta nëpërmjet organizimit të punëtorëve me prindër dhe qytetarë aktiv që veprojnë në lokalitetet ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali. Këto aktivitete do të realizohen në Qendra Mësimore me bazë në shkollë ku do të përshkruhen temat e rëndësishme të vijueshmërisë, parandalimit të mungesave të paarsyeshme, identifikimit të rasteve të vështira me probleme në familje dhe të gjitha rastet tjera të cilat prindërit i kanë informuar kujdestarët ose personelin e qendrave mësimore.
Aktivizimi i dhe fuqizimi i EPRBM në të tri nivelet e arsimit parauniversitar	MASHT në bashkëpunim me ECMI(Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve ) i ka kushtuar një vëmendje të veçantë me një varg iniciativave dhe aktivitetet që qështjes së braktisjes dhe kanë kërkuar nga DKA komunale që të hartojnë planin e veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit në këtë kontekst edhe DKA Në Lipjan ka hartuar planin e veprimit për fuqizim dhe aktivizim të EPRBM-ve
Rezultati 1.2: Rritja e pjesëmarrjes dhe zvogëlimi i rasteve të braktisjes nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkalinë Komunën e Lipjanit.	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit

<p><b>Aktiviteti 1.2.1:</b> Krijimi i një bazë të të dhënave për fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali në Komunën e Lipjanit</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.2.1:</b> DKA në bashkëpunim me ZKKK-në, shkollat, qendrat mësimore me bazë në shkollë , OJQ-të dhe grupet tjera avokuese në Komunën e Lipjanit do të bëjnë hulumtim në teren duke identifikuar të gjitha rastet e braktisjes dhe të gjithë atyre që vijnë në arsimin e obligueshëm, atë të mesëm të lartë dhe arsim të lartë. Si rezultat Komuna do të përgatisë një bazë të të dhënave ku pasqyrohen të gjitha informatat rreth arsimit të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit për të ofruar informata të mjaftueshme për të gjitha palët e interesit që punojnë në fushën e arsimit në Komunën e Lipjanit. Ky aktivitetet përveç fushës së arsimit gjithashtu do të përfshijë edhe fushën e banimit, shëndetësisë dhe punësimit, me qëllim të pasqyrimin të përgjithshëm të gjendjes së komuniteteve rom, ashkalinë Komunën e Lipjanit.</p>
<p><b>Aktiviteti 1.2.2:</b> Realizimi i fushatave informuese dhe regjistrimi i fëmijëve dhe nxënësve në shkollë IP dhe në qendra mësimore me bazë në shkollë</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.2.2:</b> ZKKK dhe DKA e Komunës së Lipjanit, në bashkëpunim me IP-të dhe shkollat, si dhe me përkrahjen edhe të QM-ve, të grupeve avokuese dhe të donatorëve të ndryshëm do t'i ndihmojnë prindërit edhe rreth procedurave dhe dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve. Gjithashtu akterët e mësipërm do të organizojnë fushata informuese për familjet e komuniteteve rom, ashkali para dhe gjatë afatëve të regjistrimit të fëmijëve dhe nxënësve në të gjitha nivelet e institucioneve edukativo-arsimore parauniversitare (IP dhe shkolla), në mënyrë që askush të mos mbetet pa u regjistruar për shkak të mungesës së informatave. Këto fushata informuese dhe ndihmesa për regjistrim bëhen në baza vjetore (në afatet e regjistrimit) dhe mund të realizohen përmes formave dhe mjeteve të ndryshme, si: shpërndarja e fletëpalosjeve informuese nëpër shtëpi të komuniteteve, nëpër QM, IP dhe shkolla, organizim i takimeve informuese dhe ndihmuese me prindër nëpër QM, IP dhe shkolla, etj.</p>
<p><b>Aktiviteti 1.2.3:</b> Vazhdimi i mbështetjes së Qendrave Mësimore me bazë në shkollë në Komunën e Lipjanit</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.2.3:</b> DKA dhe ZKKK në bashkëpunim me donatorët do të vazhdojnë të mbështesin qendrat mësimore me bazë në shkollë në Komunën e Lipjanit duke planifikuar fonde edhe për vitet në vijim me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në shkollë, përmirësimit të vijueshmërisë dhe parandalimit të braktisjes.</p>
<p><b>Aktiviteti 1.2.4:</b> Stimulimi i regjistrimit të fëmijëve në edukimin parashkollor</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.2.4:</b> Komuna e Lipjanit do të stimulojë regjistrimin e fëmijëve të komuniteteve në IP-në publike, duke caktuar një kuotë për ta dhe duke marrë përsipër mbulimin e pjesshëm apo të tërësishëm të shumës së participimit për këta fëmijë të komuniteteve rom, ashkali .</p>
<p><b>Aktiviteti 1.2.5</b> Mbështetja e nxënësve të shkollave të mesme me bursa</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.2.5:</b> Komuna e Lipjanit me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në arsimin e mesëm të lartë e dhe për të stimuluar përveç pjesëmarrjes edhe rritjen e suksesit të nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali do të ofrojë bursa për nxënësit që janë vijues të rregullt të shkollës dhe që ballafaqohen me gjendje të rëndë socio-ekonomike. Bursat për këta nxënës do të jepen me këste mujore me qëllim të sigurimit të vijueshmërisë dhe rezultateve për të cilat Komuna në çdo semestër do të analizojë vijueshmërinë dhe suksesin e nxënësve përfitues.</p>

<p><b>Aktiviteti 1.2.6:</b> Përkrahja e nxënësve të familjeve në gjendje të rëndë sociale me veshmbathje dhe pako shkollore</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.2.6:</b> Komuna e Lipjanit identifikon familjet e komuniteteve rom, ashkali me gjendje shumë të rëndë ekonomike, të cilat kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar, për të cilët nuk kanë kushte minimale për t'i dërguar në shkollë (si veshmbathje dhe materiale shkollore) dhe i përkrahë nxënësit e këtyre familjeve me pako shkollore (çanta, fletore, lapsa, ngjyra, etj.) në baza vjetore, në mënyrë që këta nxënës të kenë mundësi dhe motiv për t'u regjistruar dhe për ta vijuar shkollimin e detyruar. Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet komuna, Komuna e Lipjanit mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës edhe me veshmbathje. Të gjitha këto, përveç që i kontribuojnë rritjes së përfshirjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në shkollimin e detyruar, në të njëjtën kohë i kontribuojnë edhe zvogëlimit të rasteve të braktisjes së shkollimit nga këta nxënës.</p>
<p><b>Rezultati 1.3: Përmirësimi i suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.</b></p>	
<p><b>Aktiviteti</b></p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit</b></p>
<p><b>Aktiviteti 1.3.1:</b> Organizimi i mësimin plotësues në shkollat për nxënësit me sukses jo të mirë</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.3.1:</b> DKA e Komunës së Lipjanit në bashkëpunim me shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali sigurohet që secila nga këto shkolla kërkon nga mësimdhënësit e lëndëve të ndryshme që të ofrojnë mësim plotësues (jashtë orarit) për nxënësit e këtyre komuniteteve që kanë sukses jo të mirë, në mënyrë që ata të përkrahen që t'i zotërojnë sa më mirë përmbajtjet mësimore që kërkohen nga shkolla dhe lëndët përkatëse.</p>
<p><b>Aktiviteti 1.3.2:</b> Mbështetja dhe rritja e bashkëpunimit me QM-të në bazë në shkollë me qëllim të rritjes së rezultateve të të nxënësve për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit</p>	<p><b>Përshkrimi i aktivitetit 1.3.2:</b> DKA e Komunës së Lipjanit do të vazhdojë të mbështesë qendrat mësimore nëpërmjet bashkëfinancimit me donatorët dhe do të inkurajon shkollat dhe mësimdhënësit e shkollave ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali, posaçërisht kujdestarët e klasave ku ka nxënës të këtyre komuniteteve që të rrisin bashkëpunimin me prindërit e këtyre nxënësve. Kujdestarët e klasave organizojnë takime të rregullta mujore me prindërit, ku i informojnë prindërit me sukseset dhe ngecjet e nxënësve të tyre, i informojnë ata për mundësitë e vijimit nga ana e nxënësve të mësimin shtesë në QM, si dhe kërkojnë nga prindërit që t'i motivojnë dhe t'i përkrahin sa më shumë fëmijët e tyre për përmirësimin e suksesit gjatë shkollimit.</p>

## Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- ZKKK, DKA dhe institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit kanë vullnet dhe angazhohen për rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjeve të shkollimit dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali në arsimin parauniversitar, duke i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument.
- Komuna e Lipjanit ndanë buxhetin e paraparë për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument.
- Komuna do të bashkëpunojmë me të gjitha organizatat joqeveritare që merren me regjistrimin e gjendjes civile, të kuminetetev rom dhe ashkali.
- QM-të me bazë në shkollë vazhdojnë të përkrahen nga donatorët ekzistues për ofrimin e shërbimeve të tyre për këto komunitete.
- Institucionet qendrore të Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë përkrahin Komunën e Lipjanit dhe QM-të ekzistuese në funksion të realizimit të aktiviteteve të parapara me këtë dokument.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Bashkëpunimi ndërmjet shkollave dhe DKA-së për planifikim mund të mos jetë në nivelin e duhur që do të shkaktojë vështirësi në planifikim.
- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të ZKKK-së, DKA-së dhe institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit për t'i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument.
- Mos ndarja e buxhetit nga Komuna e Lipjanit, nga institucionet qendrore dhe nga donatorët për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument.
- Qendrat Mësimore mund ta reduktojnë ose ta ndërprejnë fare aktivitetin e saj për shkak të mospërkrahjes financiare nga donatorët aktualë.
- Mungesa e vullnetit të mësimdhënësve të ofrojnë orë shtesë në kuadër të mësimin plotësues në qendra mësimore.

## 5.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Qasja në punësim, skemat e mbrojtjes sociale dhe shërbimet sociale kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të individit dhe komunitetit. Aktualisht, niveli i punësimit i komuniteteve rom dhe ashkali është shumë i ulët (edhe në krahasim me komunitetet tjera), ndërsa përfshirja në skema e shërbimeve sociale mbetet e kufizuar. Qasja e këtyre komuniteteve në punësim, në shërbime të punësimit, në mundësi për zhvillim profesional, dhe në skemat e shërbimeve sociale duhet përmirësuar, si dhe duhet siguruar që këto të reflektojnë nevojat specifike të këtyre dy komuniteteve të synuara. Aktivizimi në treg të punës dhe krijimi i mundësive të reja për zhvillim profesional, dhe jo varësia nga skemat e ndihmave sociale, mbeten synim kryesor në drejtim të përmirësimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale të këtyre komuniteteve. Në vijim janë paraqitur sfidat kryesore të identifikuar në Komunën e Lipjanit:

**Niveli i lartë i papunësisë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali.** Gjendja në Komunën e Lipjanit si edhe në tërë Kosovën ku banojnë komunitetet rom, ashkali është në shkallë shumë të ulët. Gjithashtu edhe në nivel të institucioneve publike janë të nën përfaqësuar në Komunën e Lipjanit.

**Mungesa e kuadrove me shkollim superior dhe kualifikime tjera profesionale nga radhët e komuniteteve rom, ashkali**

Mungesa e kuadrove është një prej problemeve kryesore që ndikon në nivelin e papunësisë gjithashtu këtu pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali janë të diskriminuar edhe në tregun e punës ose paguhen nën vlerën e tregut në sektorin privat.

**Sfida 3: Gjendja e rëndë socio-ekonomike dhe qasja në skemat e mbrojtës sociale.**

Niveli i ulët i punësimit, mungesa e regjistrimit civil dhe mungesa e regjistrimit civil të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve dhe informimi i pamjaftueshëm rreth skemave të mbrojtjes sociale në Komunën e Lipjanit pasqyrojnë një gjendje të rëndë të komuniteteve rom, ashkali.

### Objektivi

Bazuar në sfidat e identifikuar më lartë në Komunën e Lipjanit është e vendosur objektivi strategjik në vijim:

- **Objektivi 2: Rritja e punësimit dhe përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.**

Për tu arritur ky objektivi Komuna e Lipjanit parashihet të arrijë rezultateve në vijim:

### Rezultatet e pritshme

- **Rezultati 2.1:** Rritet numri i të punësuarëve të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali
- **Rezultati 2.2:** Rritet numri i të aftësuarëve me trajnime profesionale dhe përgatitje superiore të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali
- **Rezultati 2.3:** Përmirësohet gjendja socio-ekonomike dhe pjesëmarrja në skemat e mbrojtës sociale.

Për të arritur rezultatet e përmendura më lartë parashihen të ndërmerren aktivitetet në vijim:

## Aktivitetet

### Rezultati 2.1: Rritet numri i të punësuarëve të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali.

Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 2.1.1: Hulumtimi i nevojave të tregut në Komunën e Lipjanit dhe identifikimi i numrit të pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga Komuna.	Komuna e Lipjanit do të analizojnë mundësitë e shfrytëzimit të informatave ekzistuese të tregut në Komunën e Lipjanit dhe të ofrojë këto informata për komunitetet me qëllim të ndërlikdhjes së këtyre informatave me punëkërkuessit (përfshirë sektorët publik, privat, dhe llojet e punëve të përkohshme, të rregullta etj) nga radhët e komuniteteve rom, ashkali me qëllim të rritjes së punësimit në nivel komune.
Aktiviteti 2.1.2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom, ashkali në punësimin në institucione dhe ndërmarrje publike.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.1.2:</b> Komuna do të informojë dhe të fusë në listë prioritare kandidatët potencial të kualifikuar nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali Me qëllim të sigurimit të përfaqësimit të tyre në përputhje me përbërjen populatës në nivel komunal siç parashihet edhe me ligj.
Aktiviteti 2.1.3: Rritja e numrit të të punësuarave në sektorin privat.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.1.3:</b> Komuna do të bashkëpunojë ngushtë me bizneset private dhe do të ndajë informatat me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali për mundësinë e punësimit. Komuna do të ndërmerre edhe hapa konkret përmes stimulimit të bizneseve private me qëllim të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali
Aktiviteti 2.1.4: Stimulimi i vetë-punësimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.1.4:</b> Komuna do të ndërmerre një seri masash me anë të subvencioneve në sektorin e bujqësisë duke i stimuluar pjesëtarët e komuniteteve të përfshihen në këtë sektor duke marrë parasysh pozicionin e mirë gjeografik të Komunës së Lipjanit dhe njëkohësisht do të ofrojë edhe ndihmë administrative dhe këshilluese për hapjen e bizneseve të reja.

### Rezultati 2.2: Rritet numri i të aftësuarve me trajnime profesionale dhe përgatitje superiore të pjesëtareve të komuniteteve rom dhe ashkali.

Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 2.2.1: Ofrimi i stimulimit financiar në formë burse për ndjekjen e trajnimeve profesionale	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.2.1:</b> Komuna do të ofrojë një stimulim simbolik financiar me qëllim të stimulimit të ndjekjes së trajnimeve profesionale në bazë të hulumtimit të nevojave të tregut në Komunën e Lipjanit për të rinjtë e komuniteteve rom, ashkali dhe eventualisht punësimit të tyre.
Aktiviteti 2.2.2: Përfshirja e pjesëtareve të diplomuar nga komunitetet rom, ashkali të posa diplomuar në punë praktike në sektorin publik.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.2.2:</b> Komuna do të informojë dhe krijojë mundësi për ofrimin e praktikës profesionale për të diplomuarit nga komunitetet rom, ashkali në Komunën e Lipjanit e që rrjedhojë e pranimit të këtij trajnimi profesional në shërbim do t'iu ofrojë përparësi në punësimin e rregullt si në sektorin publik po ashtu edhe në atë privat.

### Rezultati 2.3: Përmirësohet gjendja socio-ekonomike dhe pjesëmarrja në skemat e mbrojtës sociale.

Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
<b>Aktiviteti 2.3.1</b> Organizmi i fushatave informuese për skemat e mbrojtjes sociale dhe shërbimet sociale	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.3.1:</b> Komuna do të organizojë fushata informuese në tërë Komunën e Lipjanit në lidhje me llojet e skemave sociale dhe si të kenë qasje. Kjo do të bëhet duke realizuar vizita në familje, shpërndarje të broshurave, kontakteve direkte me pjesëtarët e komuniteteve, etj.. Theks i veçantë do ti kushtohet të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
<b>Aktiviteti 2.3.2:</b> Përfshirja në mbrojtje sociale për familjet të cilat nuk kanë mundur të jenë pjesë e skemës.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.3.2:</b> Komuna do të rishikojë numrin e familjeve që aktualisht janë përfitues të skemës sociale dhe do të identifikojë ato familje të cilat për arsye të mungesës së dokumentacionit ose shkaqeve tjera nuk kanë mundur të jenë pjesë e skemës. Komuna do të asistojë në kompletimin e dokumentacionit dhe do të sigurohet që të gjitha familjet e tilla të jenë pjesë në të gjithë Komunën e Lipjanit.
<b>Aktiviteti 2.3.3:</b> Parandalimi i daljes së fëmijëve në rrugë për lëmosh dhe parandalimi i përfshirjes së tyre në punë të rënda fizike	<b>Përshkrimi i aktivitetit 2.3.3:</b> Komuna do të krijojë grupe të përbashkëta në bashkëpunim me shoqërinë civile duke hartuar programe të caktuara me qëllim të largimit të fëmijëve nga rruga dhe kthimin e tyre në shkollat rregullta. Njëkohësisht do të identifikojë rastet ku fëmijë nga komunitetet përdoren nën moshën e lejuar të kryejnë punë fizike përmes Inspektoratit të Punës.

### Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Komuna do të jetë bashkëpunuese me komunitetin rom, ashkali me qëllim të arritjes së planit dhe objektivave.
- Komuna do të bashkëpunojë me sektorin privat, OJQ-të dhe donatorët me qëllim të thithjes së fondeve për investim në sektorin privat të kësaj komune.
- Komuna do të bashkëpunojmë me të gjitha organizatat joqeveritare që merren me regjistrimin e gjendjes civile, të komuniteteve rom dhe ashkali.
- Ekziston interesimi i komuniteteve rom dhe ashkali, përfshirë gratë, për të shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit të shkathtësive dhe pjesëmarrjes në MATP.
- Rritja e numrit të nxënësve që vijojnë arsimin e mesëm të lartë dhe universitar do të përcaktojë edhe numrin e të punësuarve në institucionet publike dhe private.
- Komuna e Lipjanit do të rrisë buxhetin në sektorin e bujqësisë.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Niveli i krijimit të vendeve të reja të punës në nivel të Komunës së Lipjanit
- Buxheti i pamjaftueshëm për masa aktive të tregut të punës.
- Mungesa e buxhetit shtesë për shërbimet e reja për tu ofruar nga QPS-të.
- Mos-regjistrimi civil i të gjithë pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.
- Mos-interesimi i donatorëve për të investuar në Komunën e Lipjanit.

### 5.3. Shëndetësia

Sikur në vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore, një numër i madh i familjeve të komuniteteve rom, ashkali jetojnë nën kufirin e varfërisë, me më shumë se 36% në varfëri të skajshme . Shumë studime kanë treguar ndikimin negativ të varfërisë në shëndetin dhe jetëgjatësinë. Njerëzit me nivele të ulëta të të ardhurave janë veçanërisht të pambrojtur nga sëmundjet e përshpejtuara nga kualiteti i dobët si dhe mënyrat jo adekuate e të ushqyerit . Në vijim janë paraqitur sfidat kryesore të identifikuar në Komunën e Lipjanit:

Vaksinimi i pjesës së mbetur rreth 25% të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.

Ekziston një numër i fëmijëve që ende nuk janë vaksinuar që është rreth 25% dhe ekziston rreziku që këta fëmijë të mos vaksinohen fare për arsye të rezistencës së prindërve ndaj vaksinimit të fëmijëve të tyre, besimit në teori konspirative, si dhe për arsye tjera, e që si sfida shihet qasja e kufizuar në shërbimet parandaluese dhe kurative shëndetësore.

Mungesa e vetëdijesimit rreth çështjeve jetike shëndetësore për komunitetet rom, ashkali.

Objektivi

Bazuar në sfidat e identifikuar më lartë në Komunën e Lipjanit është e vendosur objektivi strategjik në vijim:

**Objektivi 3: Rritja e qasjes në shërbime shëndetësore dhe përmirësimi i kualitetit të jetës së komuniteteve rom, ashkali**

Për tu arritur ky objektivi Komuna e Lipjanit parasheh arritjen e rezultateve në vijim:

#### Rezultatet e pritshme:

- **Rezultati 3.1:** Të gjithë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali të jenë të vaksinuar.
- **Rezultati 3.2:** Përmirësohet sjellja dhe praktika shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.
- **Rezultati 3.3:** Përmirësohet cilësia e jetës së komuniteteve rom, ashkali në aspektin shëndetësor në Komunën e Lipjanit.

Për të arritur rezultatet e përmendura më lartë parashihen të ndërmerren aktivitetet në vijim:

#### Aktivitetet

Rezultati 3.1: Të gjithë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali të jenë të vaksinuar.	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
Aktiviteti 3.1.1: Organizimi i fushatave për identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar në Komunën e Lipjanit	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.1.1:</b> Komuna respektivisht Drejtoria e Shëndetësisë do të formojë një ekip shëndetësor që do të realizojë vizita në terren për të identifikuar familjet respektivisht fëmijët e pa vaksinuar në Komunën e Lipjanit. Si rezultat do të krijohet një bazë e të dhënave dhe të gjithë QKMF-të dhe punktet do të jenë të njoftuara për të intervenuar në të gjitha rastet e tilla të evidentuara. Në përkrahje nga UNICEF, IKShPK dhe OJQ „Sunflowers” kemi kryer fushatë të vaksinimit për komunitetin rom dhe ashkali në vendbanimet: Lipjan, Gadime, Magure, Medvec, Janjevë dhe Hallaq i vogël.

<b>Aktiviteti 3.1.2:</b> <b>Realizimi i vizitave të rregullta në familje dhe qendrat e komunitetit për familjet e komuniteteve rom, ashkali</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.1.2:</b> Komuna do të angazhojë ekipet mobile shëndetësore që do të realizojnë vizita në lokalitetet ku banojnë komunitetet rom, ashkali qëllim të vaksinimit të fëmijëve të cilët ende nuk e kanë pranuar këtë shërbim. Në kuadër të vizitave në shtëpi janë kryer vizita në familje të komunitetit, nga ekipet e maternitetin të QKMF-Lipjan.
<b>Rezultati 3.2: Përmirësohet sjellja dhe praktika shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.</b>	
<b>Aktiviteti</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>
<b>Aktiviteti 3.2.1:</b> <b>Organizimi i fushatave informuese për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.2.1:</b> Ekipet shëndetësore do të kryejnë vizita, shpërndajnë fletushka, organizojnë takime me komunitetin me qëllim të vetëdijesimit për rëndësinë e shëndetit. Caku i programeve të tilla është edukimi i grave, burrave dhe të rinjve duke u ofruar atyre shkathësi dhe njohuri për jetën mbi shëndetin riprodhues, përfshirë planifikimin familjar përmes organizimit të sesioneve në komunitete dhe sesioneve trajnuese në shkolla, dhe po ashtu përmes financimit të iniciativave për ngritjen e ndërgjegjes rreth çështjeve të ndryshme të popullsisë përmes fushatave, mediave dhe tryezave të rrumbullakëta. Në periudhën Shtator 2022-Mars-2023 janë kryer 20 sesione informuese nga ekipet e trajnuara të maternitetit për planifikim familjar kryesisht me gara të mbështetura nga UNICEF, përmes OJQ AMC(ActionforMatherandChildren)
<b>Aktiviteti 3.2.2:</b> <b>Angazhimi i ekipeve mjekësore në shtëpi për nëna dhe fëmijë dhe grupe tjera të ndjeshme</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.2.2:</b> Ekipet mjekësore do të realizojnë vizita të rregullta në shtëpi për nëna dhe fëmijë, në shkolla dhe qendra të komunitetit me qëllimin e rritjes së qasjes në shërbimet shëndetësore, edukative edhe konsultative që lidhen me kujdesin shëndetësor të nënave edhe fëmijëve. Në kuadër të vizitave në shtëpi ekipet nga materniteti dhe infermieret e trajnuara në punkte kanë kryer vizita në familjet e komunitetit.
<b>Rezultati 3.3:</b>	
<b>Përmisohet cilësia e jetës së romve dhe ashkalive në aspektin shëndetësor në Komunën e Lipjanit.</b>	
<b>Aktiviteti</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>
<b>Aktiviteti 3.3.1:</b> <b>Shpërndarja e pakove higjienike për familjet me gjendje të rëndë ekonomike të komuniteteve rom, ashkali.</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.3.1:</b> Komuna do të identifikojë familjet në nevojë dhe do të shpërndajë pako higjienike për të lehtësuar dhe parandaluar sëmundjet si dhe do ti ofrojë këshillim për rëndësinë e kushteve higjienike-sanitare. Janë shpërndarë 200 pako higjienike për familjet e komunitetit në periudhën shtator 2022- mars 2023 në Lipjan dhe Gadime.

<b>Aktiviteti 3.3.2:</b> <b>Subvencionimi i familjeve me gjendje të rëndë ekonomike për sigurimin e medikamenteve të nevojshme</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.3.2:</b> Komuna do të ofron subvencione për familjet të cilat jetojnë në kushte të rënda ekonomike të cilat ballafaqohen me rastet me sëmundje të rënda. Subvencionimi i këtyre rasteve ka për qëllim që sado pak të ndihmojë familjet në nevojë në përballimin e shpenzimeve të shërbimeve shëndetësore dhe medikamenteve të nevojshme.
<b>Aktiviteti 3.3.3:</b> <b>Shfaqja e epidemisë akute të Hepatit A në fshatin Gadime e Ulet</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.3.3:</b> Komuna edhe në të kaluarën ka ndërmarrë një sërë veprimesh dhe gjatë kësaj periudhe planifikon të intensifikojë aktivitetet në dezinfektimin burimeve të ujit të pijes përmes klorizimit në fshatin Gadime ose në ndonjë lokacion tjetër potencial.
<b>Aktiviteti 3.3.4:</b> <b>Furnizimi me barna esenciale dhe lirimi nga pagesa për participim</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit 3.3.4:</b> Komuna do të sigurohet të ofrojë barnat esenciale në lokalitetet ku banojnë komunitetet rom, ashkali me qëllim të lehtësimit të qasjes në këto shërbime si dhe do të vë në dispozicion një veturë të ndihmës së shpejtë që do të frekuentojë në baza të rregullta në veçanti vendbanimet rurale ku janë të shtrira këto komunitete. Furnizimi me barna kryet në QKMF-Lipjan, QMF-Magure, QMF-Gadime, QMF-Janjevë, AMF-Silovi, si dhe në të gjitha punktet tjera shëndetësore, ku ju është mundësuar qasja e lehtë në këto barna. Vetëm furnizimi me Insulinë për të gjithë qytetarët kryhet vetëm në QKMF-Lipjan

### **Supozimet dhe rreziqet**

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Në baze të statistikave në rritje të sëmundjeve kronike dhe përkeqësimit të gjendjes ekonomike supozojmë se do të ketë nevojë për rritjen e numrit të familjeve që do të kenë nevojë për ndihmë;
- Përkeqësimi i gjendjes ekonomiko- sociale determinon pashmangshëm edhe rritjen e numrit të familjeve që do të ndihmohen me pako higjienike dhe ushqimore;
- Shfaqja e epidemisë akute të Hepatit A në fshatin Gadime e Ulet.

## 5.4. Banimi

Çështja e banimit në Kosovën e pasluftës ka qenë dhe mbetet sfidë e shoqërisë sonë. Në veçanti, këtë sfidë e hasim tek komunitetet rom, ashkali, të cilët janë ballafaquar me probleme të kësaj natyre edhe para vitit 1999. Mungesa e numrit të mjaftueshëm e shtëpive/banesave është evidente dhe duhen të ndërmerren masa përmirësuese në drejtim të reduktimit të numrit të atyre pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali që nuk kanë banim adekuat. Në vijim janë paraqitur sfidat kryesore të identifikuara në Komunën e Lipjanit:

### **Ekzistenca e vendbanimeve joformale ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.**

Edhe në komunën e Lipjanit egzistenca e vendbanimeve jo formale është vlerësuar si një ndër problemet kyçe për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali.

### **Rritja e numrit të familjeve të pastrehë të familjeve të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.**

Kërkesat e familjeve të pastreha janë në rritje në këtë komunë kjo për arsye se janë krijuar familje të reja dhe vendbanimet kanë hapësirë të kufizuar për numrin e anëtarëve që aktualisht jetojnë në vendbanimet ekzistuese.

### **Kushte jo të përshtatshme dhe të vështira për jetesë në shumë lokalitete ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali.**

Në të gjitha banimet kolektive dhe ato joformale ku jetojnë komunitetet rom, ashkali, kushtet vlerësohen të jenë jo adekuate mungon edhe mirëmbajtja e rregullt dhe varfëria e këtyre komuniteteve i kufizon të ndërmarrin veprime të përbashkëta banorët në rregullimin e kushteve të jetesës.

### **Mungesa e mjeteve financiare dhe e pronave publike për mbështetjen e banimit të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.**

Komuna edhe pse ka hartuar programin trevjeçar për banim ku parashihet se brenda kësaj periudhe të paraparë në program të subvencionohen familjet për renovim të shtëpive, për përfundimin e shtëpive të cilat kanë filluar si dhe ndërtimi i një objekti banesor ku do të përfshihen edhe komunitetet rom dhe ashkali.

Për realizimin e këtij programi tre vjeçar të banimit komuna do të ndajë një pjesë të buxhetit, kurse një pjesë tjetër do ta kërkojë nga ministrinë përkatëse dhe donatorët shumicën e aktiviteteve i mbështet në ndihmë nga Ministrinë përkatëse dhe donatorët. Janë 148 familje që kanë parashtruar kërkesat për strehim ndërtim dhe renovim të shtëpive ku prej tyre janë 32 familje të komuniteteve rom, ashkali

### **Objektivi**

Bazuar në sfidat e identifikuara më lartë në Komunën e Lipjanit është e vendosur objektivi strategjik në vijim:

### **Objektivi 4: Sigurimi i strehimit, banimit formal dhe përmirësimi i kushteve të banimit për të gjitha familjet e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.**

Për tu arritur ky objektivi Komuna e Lipjanit parasheh arritjen e rezultateve në vijim:

### **Rezultatet e pritshme**

- **Rezultati 4.1:** Zvogëlohet numri i vendbanimeve joformale ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.
- **Rezultati 4.2:** Sigurohet banim për familjet e pastrehë të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.

- **Rezultati 4.3:** Përmirësohen kushtet ekzistuese të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.

Për të arritur rezultatet e përmendura më lartë parashihen të ndërmerren aktivitetet në vijim:

### Aktivitetet

Rezultati 4.1: Zvogëlohet numri i vendbanimeve joformale ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.	
Aktiviteti	Përshkrimi i aktivitetit
<b>Aktiviteti 4.1.1:</b> Legalizimi i vendbanime joformale ose ndarja e parcelave të reja për ndërtim të shtëpive	<b>Përshkrimi i aktivitetit 4.1.1:</b> Sektori për Shërbime Pronësore Juridike që funksionon në kuadër të Komunës së Lipjanit do të analizojë secilin rast dhe në pajtim me Programin trevjeçar të banimit 2022-2025 hartuar nga Komuna e Lipjanit <sup>8</sup> do të ndërmerr të gjitha masat ligjore për trajtimin e të gjitha vendbanimeve joformale me theks të veçantë në trajtimin e rasteve të komuniteteve rom, ashkali
Rezultati 4.2: Sigurohet banim për familjet e pastrehë të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.	
<b>Aktiviteti 4.2.1:</b> Sigurimi i njësive të banimit në kuadër të objekteve kolektive të banimit	<b>Përshkrimi i aktivitetit 4.2.1:</b> Komuna në kuadër të programit 3 vjeçar të banimit 2022-2025, ka parapar ndërtimin e një objekti banesor si dhe subvencionimin e disa familjeve për renovimin e shtëpive ku do të përfshihen edhe këto komunitete.
<b>Aktiviteti 4.2.2:</b> Ndërtimi i shtëpive nga themeli për familjet e pastrehë dhe familjet e reja të krijuara.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 4.2.5:</b> Komuna do të ofrojë parcelat për banime kolektive ku do të përfshihen pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali. Ky është projekt i përbashkët me bashkëfinancim me donatorët.
Rezultati 4.3: Përmirësohen kushtet ekzistuese të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.	
<b>Aktiviteti 4.3.1:</b> Realizimi i projekteve për përmirësimin e kushteve të banimit në vendbanimet ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Lipjanit.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 4.3.1:</b> Realizimi i projekteve për përmirësimin e kushteve të banimit në objektet ekzistuese të banimit kolektiv dhe individual në bashkëpunim me pronarët sipas bazës ligjore - bashkëfinancim, përmes sektorit të banimit apo subjekt i kontraktuar i licencuar për këtë veprimtari. Shih, Programin Trevjeçar të Banimit të Komunës së Lipjanit <sup>9</sup> .
<b>Aktiviteti 4.3.2:</b> Renovimi dhe zgjerimi i vendbanimeve ekzistuese të komuniteteve rom, ashkalinë Komunën e Lipjanit.	<b>Përshkrimi i aktivitetit 4.3.2:</b> Komuna në bashkëfinancim me donatorët dhe zbatuar nga OJQ-të do të identifikojë rastet e familjeve që kanë kushtet e vështira të banimit në rastet që nuk janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit si dhe hapësirat e pamjaftueshme komfor numrit të anëtarëve të familjes. Ky projekt do të realizohet në bashkëfinancim me donatorët.

